



3303/14

09 JUL 2024

KOMUNA E GRAÇANICËS**Komisioni për vlerësim**

Nr: _____/24

Data: 09.07.2024

Graçanicë

Në bazë të nenit 16 paragrafi 3 të Rregullores së MF nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Komisioni për vlerësimin e propozimeve të parashtruara në Thirrjen publike për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve të OJQ-ve me qëllim të zbatimit të masave për mbështetjen e qytetarëve në gjendje më të rëndë materiale, në mbledhjen e mbajtur më datën 08.07.2024, mori këtë:

V E N D I M

Për listën preliminare të përfituesve

1. Lista preliminare e përfituesve të mbështetjes financiare publike përbëhet nga:

Nr.r.	Emri i OJQ	Emri i projektit	Numri total i pikëve	Shuma e aprovuar e projektit në €
1.	NVO "Pupin"	"Graçanica NextGen"	80,2	80,000.00 €

2. Aplikacionet e OJQ-ve që kanë marrë më pak se 50 pikë dhe për këtë arsye nuk janë kualifikuar për mbështetjen financiare:

Nr.	Emri i OJQ	Emri i projektit	Numri i pikave mesatare
1.	NVO "Centar za afirmaciju mladih Graçanica"	"Obuka i web razvoj"	44,2

3. Rezultatet preliminare bëhen përfundimtare pas përfundimit të të gjitha procedurave të parashikuara nga Rregullorja MF-nr-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

4. Vendimi publikohet në ueb- faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Arsyetim

Komuna e Graçanicës më datën 12.06.2024 ka shpallur Thirrje publike nr.2889/24 për mbështetjen financiare publike të projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e zhvillimit ekonomik-aktivitetëve për rritjen e punësimit dhe mbështetjen "start-up" dhe bizneseve të vogla, në një shumë totale deri në 80.000 euro. Thirrja publike ishte e hapur për 15 ditë pune nga dita e publikimit në


ueb-faqen zyrtare të komunës. Me Thirrjen publike janë përcaktuar kriteret për paraqitjen e projekteve dhe formularët e detyrueshëm që duhet të dorëzohen me rastin e aplikimit. Me vendimin e kryetares së komunës nr.3120/24 të datës 27.06.2024 është formuar Komisioni për vlerësimin e projekteve të paraqitura në Thirrjen publike. Në mbledhjen e Komisionit për vlerësimin e propozimeve të dorëzuara në Thirrjen publike (Procesverbali nr.3280/24) të mbajtur më datën 08.07.2024 është bërë hapja e ofertave dhe me këtë rast është konstatuar si në Thirrjen publike brenda afatit të përcaktuar janë dorëzuar gjithsej 2 (dy) aplikacione dhe atë të: OJQ "Centar za afirmaciju mladih Gračanica" dhe OJQ "Pupin". Pas verifikimit, është konstatuar se projektet i plotësojnë kushtet formale të parapara me Thirrjen publike në aspektin e formularëve, dokumentacionit të nevojshëm dhe mënyrës së paraqitjes së aplikacionit. Në të njëjtën mbledhje Komisioni ka vendosur që ta bëjë edhe vlerësimin e aplikacioneve në mënyrë përmbajtësore dhe pikësimin e tyre. Propozimi i projektit të OJQ-së "Centar za afirmaciju mladih Gračanica" ka marrë numrin mesatar të pikëve 44.2 nga Komisioni, ndërsa propozimi i projektit të OJQ „Pupin“ ka marrë gjithsej 80.2 pikë. Duke pasur parasysh se projekti i OJQ-së "Pupin" nga Gračanica i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Thirrjen publike, si dhe se vetë propozimi i projektit dhe aktivitetet e planifikuara të projektit janë në përputhje me Thirrjen publike dhe se qëllimi i thirrjes do të realizohet nëse do të zbatohet, u vendos që të pranohet propozimi i projektit dhe të miratohen mjetet financiare në një shumë prej 80,000.00 euro.


Në përputhje me nenin 16 paragraf 3 të Rregullores së MF-nr-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshilli juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave pranë Komunës së Graçanicës, në afat prej 5 ditësh nga dita e publikimit të vendimit.





Komisioni për vlerësim:


Aleksandar Marinković, kryetar


Tamara Marinković, anëtare


Milica Velić, anëtare


Nemanja Čvejić, anëtar


Nikola Veselinović, anëtar

Vendimi i dorëzohet:

- Parashtruesve të projekteve - OJQ
- Kabinetit të kryetares së komunës
- Arkivi